

VENDIM
Nr. 810, datë 12.12.2022

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 646, DATË 22.7.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE E TË KRITEREVE
TË PËRZGJEDHJES SË ZHVILLUESIT NË ZONËN E TEKNOLOGJISË DHE
ZHVILLIMIT EKONOMIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe të zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 646, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 4 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Procedurë jokonkurruese për përcaktimin e zhvilluesit në rastet e investitorëve me status “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/veçantë”, sipas përcaktimeve në shkronjën “d”, të pikës 3, të nenit 8, sipas së cilës specifikohen dy nënsektorët përbërës të sektorit “zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike.”.

Neni 2

Pas nenit 14/1 shtohet neni 14/2, me këtë përmbajtje:

“Neni 14/2

Procedurë jokonkurruese për përcaktimin e zhvilluesit në rastet e investitorëve me status “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/ veçantë.”.

Përcaktimi i zhvilluesit bëhet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e institucionit përgjegjës, sipas procedurës së mëposhtme:

1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve përcjell pranë institucionit përgjegjës vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga subjekti investuese, për realizimin e projektit/investimit strategjik, zonë e teknologjisë dhe të zhvillimit ekonomik.

2. Institucioni përgjegjës, pasi ka marrë informacionin nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, për statusin aktual të pasurisë, për sipërfaqen në të cilën do të ndërtohet zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, të shoqëruar me aktin përkatës të pronësisë, në përputhje me nenin 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, i propozon Këshillit të Ministrave shpalljen e zonës dhe zhvilluesin e saj.

3. Me shpalljen e zonës, sipas pikës 2, ndërtimet pa leje nuk legalizohen, por trajtohen nga shteti nëpërmjet shpërblimit financiar, programeve financiare të strehimit ose formave të tjera alternative të trajtimit.”.

Neni 3

Pas nenit 16 shtohet neni 16/1, me këtë përmbajtje:

Anulimi i një procedure konkurruese

1. Institucioni përgjegjës me urdhër të ministrit anulon procedurën e konkurrimit, në rastet kur:

- a) në procedurat konkurruese nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;
- b) konstaton se dokumentet e konkurrimit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme që pengojnë vijimin e procedurës;
- c) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive nuk mund të zhvillohet procedura konkurruese.

2. Institucioni përgjegjës nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë, në bazë të pikës 1, të këtij neni.

3. Institucioni përgjegjës u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e konkurrimit menjëherë, por jo më vonë se 3 (tri) ditë nga marrja e vendimit.

4. Institucioni përgjegjës publikon vendimin e anulimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, vetëm pas kalimit të afateve të ankimimit, sipas parashikimeve të nenit 15/1, të këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku